



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 471/2 Prot.

Tiranë, më 19 . 03 . 2024

V E N D I M

Nr. 72, Datë 19 . 03 . 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 236 Regj., datë 30.10.2023, të subjektit ankues, A. H, kundër Bashkisë Durrës, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “aftësisë së kufizuar¹”, lidhur me mungesën e aksesueshmërisë në ambientet e këtij Institucioni.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, znj. A. H, ka informuar Komisionerin lidhur me problematikën e hasur prej saj, duke parashtruar se, ndërtesa e Institucionit të Bashkisë Durrës nuk është e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, gjë që e vë atë në kushtet e diskriminimit, duke i mohuar të drejtën për të marrë shërbimet e ofruara nga ky institucion në mënyrë të denjë e të barabartë me të tjerët, në respektim të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, i cili parashikon gjithë-përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, si dhe VKM-së nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

Në parashtrimet e depozituara pranë KMD-së, ankuesja shpreh se: “Mungon rampa në hyrje të Bashkisë Durrës dhe aksesimi në katet e brendshme mungon gjithashtu. Si person me AK, me status

¹ Referuar dokumentacionit për përfitimin e statusit të invalidit paraplegjik-tetraplegjik.

paraplegjik-tetraplegjik, kam hasur vështirësi edhe në sallën e Këshillit Bashkiak Durrës, ku është e vështirë hyrja për shkak të shkallëve. Pra, mungesa e rampave dhe ashensorit apo platformës ndihmëse, kanë bërë që unë të ndihem e diskriminuar dhe e rrezikuar për shkak të paaftësisë sime fizike, sa herë që jam ftuar për të marrë pjesë në dëgjuesat publike në sallën e Këshillit Bashkiak apo dhe e privuar për të marrë ndonjë shërbim në Institucionin e Bashkisë.”

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: *“Konstatimin e diskriminimit dhe përmirësimin e situatës dhe plotësimin e standardeve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara (PAK), nga ana e Bashkisë Durrës”.*

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 1021/2010, i ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si *“çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1208/1 prot., datë 31.10.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime, Bashkisë Durrës, lidhur me pretendimet e ngritura për çështjen në fjalë.

2. Njëpërmjet shkresës me nr. 10402/1 prot., datë 08.11.2023, Bashkia Durrës, ka dërguar pranë Komisionerit parashtrimet lidhur me qëndrimin për sa i takon çështjes në fjalë, duke cituar si më poshtë:

“...Në VKM nr.1503, datë 19.11.2008 “Për miratimin e Rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, neni 21 “Shmangia dhe zgjidhjet alternative”, në pikën 2, parashikohet se: “Në ndërtesat ekzistuese lejohet shmangia nga kërkesat e kësaj Rregulloreje në rast të një pamundësie teknike, të faktuar, lidhur me elementë të strukturës teknike të ndërtesës ose me elementë të planit territorial vendor apo kombëtar.”

Sa më sipër sqarojmë se, ndërtesa e Bashkisë Durrës është një ndërtesë e ndërtuar në vitin 1929, në sheshin tradicional të qytetit. Ky objekt ka strukturë me muraturë mbajtëse në të cilën është e pamundur teknikisht ndërhyrja në të, për të shtuar, apo ndërhyrë në elementët konstruktiv. Gjithashtu është për tu theksuar se edhe në fasadën e poshtme të ndërtesës është e pamundur vendosja e elementëve shtesë, sepse ndërpret elementë të planit territorial, siç është rruga mbrapa Bashkisë, e cila është një rrugë lidhëse për banorët dhe subjektet që banojnë dhe operojnë në atë zonë.

Për sa më sipër, çdo individ që kërkon të përmbushë një të drejtë, një detyrim apo një pretendim drejtuar Institucionit të Administratës Publike, për rastet e pamundësisë teknike të përshtatjes së ndërtesave ekzistuese, të faktuar, lidhur me elementë të strukturës teknike të ndërtesës ose me elementë të planit territorial vendor apo kombëtar, trajtuar më sipër, për të cilat lejohet shmangia nga rregullorja “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, miratuar me VKM nr. 1503/2008, e përmbush këtë detyrim njëpërmjet mënyrave alternative.

Ju bëjmë me dije se, kërkesat, ankesat, apo çdo korrespondencë me institucionin e Bashkisë apo me Këshillin vendor përkatës bëhet me shkresë zyrtare njëpërmjet institucioneve postare, postës elektronike, si dhe njëpërmjet Zyrës së Marrëdhënieve me Përbashkësinë, e cila ndodhet në katin përdhe të institucionit. Specialistët e kësaj Zyre, janë të gatshëm në çdo moment që të bëjnë të mundur adresimin e pretendimeve të personave me aftësi ndryshe, në drejtoritë përkatëse të institucionit të Bashkisë.

Njëkohësisht, për sa i përket temave që trajtohen në mbledhjet e Këshillit Bashkiak, sqarojmë se: ato janë transparente, rendi i ditës publikohet në faqen zyrtare elektronike të Bashkisë, po ashtu edhe vendimet e Këshillit Bashkiak.

Gjithashtu, vlen theksojmë se, ligji nr. 43/2023 “Për qeverisjen elektronike”, përcakton:

- a) Parimet e përgjithshme të qeverisjes elektronike;*
- b) Detyrimet e autoriteteve publike dhe subjekteve private në ofrimin e shërbimeve elektronike;*

- c) *Të Drejtat e personave fizikë, subjekteve private dhe autoriteteve publike për të komunikuar me njëri-tjetrin përmes teknologjisë së informacionit;*
- d) *Funksionimin dhe ndërveprimin midis autoriteteve publike dhe subjekteve private për qeverisjen elektronike;*
- e) *Infrastrukturën e shërbimeve elektronike;*
- f) *Sistemin e administrimit dhe protokollimit të dokumentit elektronik për institucionet e administratës shtetërore në nivel qendror dhe vendor.*

Ky ligj zbatohet nga autoritetet publike për ushtrimin e kompetencave të tyre në ofrimin e shërbimeve publike në rrugë elektronike, përmes përdorimit të sistemeve dhe rrjeteve të informacionit dhe do të mundësojë ofrimin në rrugë elektronike të shërbimeve publike për marrjen/përfitimin e të cilave nuk kërkohet domosdoshmërisht paraqitja fizike e kërkuarit.

Bashkia Durrës si autoritet publik ka krijuar dhe mirëmban faqen e saj zyrtare të internetit, e cila është lëhtesisht e aksesueshme për ofrimin e informacionit, në përputhje me ligjin dhe legjislacionin në fuqi, për të drejtën e informimit, duke garantuar saktësinë, vefshmërinë dhe ligjshmërinë e informacioneve që poston apo njofton për postim në faqen e saj zyrtare. Kjo faqe zyrtare është faqe e lirë pa kufizim aksesit për të gjithë qytetarët.

Përveç sa më sipër, neni 64, i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ka rregulluar mënyrën e përfaqësimit në rastet e pamundësisë së paraqitjes së personit.”

3. Në vijim të hapave proceduralë për shqyrtimin e kësaj ankese, mbështetur në nenin 32, pika 1/c, të LMD-së, nenin 39, të Rregullores së Brendshme të KMD-së, si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 3, datë 16.01.2024, inspektorët e KMD-së, realizuan inspektim në ambientet e Bashkisë Durrës.

Në urdhrin e inspektimit KMD, kishte kërkuar paraprakisht që nga ana e Bashkisë Durrës, të vihej në dispozicion të grupit të inspektimit, për efekt të procesit hetimor, dokumenti shkresor i përpiluar nga ekspertët e fushës apo strukturat përgjegjëse përkatëse, i cili faktori apo dëshmon për pamundësinë teknike të përshtatjes së ndërtesës aktuale të Bashkisë Durrës, lidhur me ndërhyrjet ndërtimore për aksesueshmërinë e ambienteve të kësaj bashkie, në zbatim të VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “*Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara*”.

Referuar procesverbalit të mbajtur gjatë inspektimit pranë Bashkisë Durrës, me datë 23.01.2024, evidentohet se nga ana e Nën/kryetarit të Bashkisë, z. R. M, u kërkuar që gjithë dokumentacioni i disponuar prej Bashkisë, si dhe parashtrimet e tjera, të dërgoheshin në vijim, brenda një afati 30 (tridhjetë) ditor. U dakordësua mes përfaqësuesve të Bashkisë dhe inspektorëve të KMD-së, që dokumentacioni i nevojshëm të depozitohet deri më datë 26.02.2024.

Në kushtet kur, deri në përfundim të këtij afati, dhe disponimit të dokumentacionit të cituar në procesverbal, lidhur me informacionin e relacionin teknik për vlerësimin e situatës dhe gjendjes

teknike të godinës së Bashkisë, sa i takon ndërhyrjeve specifike për aksesueshmërinë e PAK, Komisioneri, vlerësoi të ndërpresë kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore lidhur me ankesën në fjalë.

4. Për sa më sipër, në kushtet kur për këtë çështje pritet që Bashkia të depozitojë dokumentacionin e informacionin e nevojshëm të ekspertëve të fushës, si dhe në mbështetje të nenit 85/3, të Kodit të Procedurave Administrative, ku përcaktohet se: “3. Në ato raste kur informacioni apo dokumentet e kërkuara nga palët janë të domosdoshme për shqyrtimin e pretendimit të ngritur nga vetë palët, procedura pezullohet deri në sigurimin e informacionit dhe palët njoftohen për këtë gjë”,

Komisioneri, me Vendimin e tij me nr. 39, datë 07.02.2024, pezulloi shqyrtimin e çështjes të mungesës së aksesueshmërisë së ambienteve të Bashkisë Durrës, për një afat 30 (tridhjetë) ditor, deri më datë 07.03.2024.

5. Në vijim të sa më sipër, Bashkia Durrës, me shkresën nr. 2028/1 prot., datë 26.02.2024, ka përcjellë pranë KMD-së, kopjen e Relacionit Teknik, me objekt: “Aksesueshmëria e PAK në godinën e Bashkisë Durrës”, të hartuar nga ekspertët e fushës të këtij institucioni. Relacioni teknik paraqet në mënyrë të detajuar se si do të jetë planimetria e godinës pas ndërhyrjes që mendohet të realizohet lidhur me aksesueshmërinë e PAK.

Referuar parashtimeve dhe Relacionit Teknik bashkëlidhur, Bashkia Durrës, informon Komisionerin se, inxhinierët dhe arkitektët, pjesë e Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike të Bashkisë Durrës, kanë studiuar dy variante për zgjidhjen e aksesueshmërisë së PAK në godinën e Bashkisë, duke theksuar faktin se varianti i dytë i hartuar nga ekspertët e Bashkisë, është më i realizueshëm se varianti i parë i prezantuar prej tyre. Bashkia informon se, variantit më të mundshëm për realizim, pasi të konsultohet me specialistët e fushës, do t’i jepet prioritet zgjidhjes teknike të tij, nëpërmjet një projekt-preventivi, si dhe përmes parashikimit në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Referuar prezantimit të variantit të dytë, si më i mundshmi për realizim, në Relacionin Teknik të hartuar nga Bashkia Durrës, citohet se:

“...Varianti i dytë është vendosja e një ashensori platformë për shkallët, për PAK, që vendoset në të gjithë shkallët ekzistuese të godinës.

Grupi i punës është i mendimit se ky variant mund të realizohet më lehtë dhe nuk ka ndërhyrje në strukturë e cila mund të cenojë sigurinë e objektit.

Ashensorët me platformë lëvizëse përdoren në ndërtesa me akses publik ose jashtë shtëpive private. Platforma është mjaft e madhe për të akomoduar një karrige me rrota dhe përdoruesin e saj, si dhe mund të ketë palosje të skajit që bie poshtë, e po ashtu vepron si rampa për të lejuar ndryshime në nivelet e dyshemesë. Këto rampa gjithashtu ndalojnë që karrigia me rrota të kalojë në skajin e platformës.

Binarët janë domosdoshmërisht të një konstruksioni të rëndë për të mbështetur ngarkesën dhe sistemin e lëvizjes. Zakonisht vendoset brenda një shine me seksion tubular çeliku ose alumini të përforcuar.

Ky variant, ka disa avantazhe si: kosto më të lirë (se varianti me ashensor të jashtëm), nuk ndikon në gjendjen strukturale të godinës dhe ka mundësi më të shpejtë realizimi se variantii parë, si dhe pa ndërhyrje në strukturë...”

6. Në këto kushte, duke qenë se nga ana e Bashkisë Durrës u përcoll informacioni i kërkuar si dhe referuar faktit që përfundoi afati i caktuar për kthimin përgjigjes në vendimin e ndërmjetëm, Komisioneri me Vendimin nr. 71, datë 19.03.2024, vendosi ndërprerjen e pezullimit dhe çeljen e procedurës së shqyrtimit të ankesës.
7. Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit dhe transparencës, nëpërmjet e-mailit datë 05.03.2024, palës ankuese i është përcjellë dokumentacioni i dërguar nga Bashkia Durrës, si dhe Relacioni Teknik, për ndërtimin e rampës për aksesueshmërinë e PAK në godinën e këtij institucioni.
8. Pasi është njohur me dokumentin sipërcituar, subjekti ankues, nëpërmjet e-mailit të dërguar me datë 07.03.2024, është tërhequr nga ankesa e bërë pranë KMD-së, pasi ka vlerësuar reagimin e Bashkisë dhe masat e ndërmarra prej saj, pas ndërmjetësimit të Komisionerit, për sigurimin e aksesueshmërisë për PAK në godinën e këtij institucioni, në zbatim të kriterëve teknike të përcaktuara në *VKM nr. 1503, datë 19.11.2003 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*”, brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “*Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa*”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ*”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i cili parashikon se: “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për*

çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaroi përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 236, datë 30.10.2023, të subjektit ankues A. H kundër Bashkisë Durrës, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Bashkia Durrës, pas miratimit të Projekt-preventivit, në zbatim të Relacionit Teknik, me objekt: “Aksesueshmëria e PAK në godinën e Bashkisë Durrës”, si dhe miratimit të tij në buxhetin përkatës, të depozitojnë pranë KMD-së kopje të dokumentacionit provues për sa më sipër.
3. Bashkia Durrës, në përfundim të realizimit dhe zgjidhjes përfundimtare të aksesueshmërisë së PAK në godinën e Bashkisë Durrës, të depozitojnë pranë KMD-së dokumentacionin përkatës dhe fotot ilustruese, lidhur me respektimin e kriterëve teknike e ligjore të aksesueshmërisë, sipas VKM nr. 1503, datë 19.11.2003 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””.
4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Bashkia Durrës, të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

